

Vendosja në qarkullim të lirë

Neni 103

1. Vendosja në qarkullim të lirë u jep mallrave jo shqiptare statusin doganor të mallrave shqiptare.
2. Kjo sjell zbatimin e masave të politikës tregtare, kryerjen e formaliteteve të tjera të parashikuara për importimin e mallrave si edhe pagesën e detyrimeve të importit.

Neni 104

Kur një dërgesë përbëhet nga mallra me klasifikim tarifor të ndryshëm dhe trajtimi i secilit prej tyre sipas klasifikimit të duhur për të përgatitur deklaratën sjell si pasojë një punë të madhe e shpenzime të tepruara në krahasim me detyrimet e importit që duhen paguar, autoritetet doganore, me kërkesë të deklaruesit mund të bien dakord që detyrimet e

54

importit të paguhen mbi të gjithë ngarkesën në bazë të klasifikimit tarifor të mallrave që kanë nivelin më të lartë të detyrimit të importit.

Neni 105

1. Mallrat e vendosura në qarkullim të lirë, me një nivel të reduktuar ose zero të detyrimeve të importit, për arsye të përdorimit të veçantë të tyre, do të mbeten nën mbikqyrjen doganore. Kjo mbikqyrje përfundon kur kushtet për përfitimin e nivelit të reduktuar ose zero të detyrimeve pushojnë së ekzistuari, kur mallrat eksportohen ose asgjesohen, ose kur lejohet përdorimi i mallrave për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara për zbatimin e nivelit të reduktuar ose zero të detyrimit, me kusht që të paguhen detyrimet përkatëse.
2. Nenet 111 dhe 113 zbatohen *mutatis mutandis* për mallrat e përmendura në paragrafin 1.

Neni 106

Mallrat e vendosura në qarkullim të lirë humbasin statusin doganor të mallrave shqiptare kur:

- a) deklarata doganore për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë bëhet e pavlefshme pas çlirimit të mallrave, në përputhje me nenin 91; ose
- b) detyrimet e importit që duhen paguar për këto mallra janë rimbursuar ose shuar:
 - i) nën regjimin e përpunimit aktiv në formën e sistemit me rimbursim; ose
 - ii) lidhur me mallrat me defekte, të cilat nuk u përgjigjen kushteve të kontratës sipas nenit 251; ose

iii) në situata si ato të përmendura në nenin 252, kur rimbursimi ose shuarja është e kushtëzuar nga eksportimi ose riekportimi i mallrave ose nga dhënia e një destinacioni doganor të barazvlefshëm.